

20120541540

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 25 paragrafi 6 dhe nenit 47 paragrafi 1 pika 6 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM PËR VLERËN MË TË ULËT NOMINALE TË DENARËVE NË QARKULLIM

1. Vlera më e ulët e denarëve në qarkullim, me të cilën rrumbullakohet llogaritja përfundimtare me dhe pa para të gatshme në qarkullim pagesor dhe në librat tregtar, është 1 denar.
2. Nëse gjatë llogaritjeve paraqiten shuma që janë rreth një denar, do të rrumbullakohen, ashtu që shuma deri më 49 deni nuk do të merret parasysh, ndërsa shuma nga 50 deri 99 deni, do të rrumbullakohet në 1 denar.
3. Nga dita e zbatimit të këtij vendimi, pushon së qenuri në fuqi Vendimi për vlerën më të ulët nominale të denarëve në qarkullim nr. 02-15/54-93 nga data 30.04.1993.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga shpallja në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe do të zbatohet nga data 01.01.2013.

Nr.V. 02-15/V-2/2012
26 prill viti 2012
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov